



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

AKT NORMATIV

Nr. 4, datë 5.2.2021

PËR

**DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.137/2020, "PËR BUXHETIN
E VITIT 2021"**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në ligjin nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Nenet 1, 2 dhe 9, ndryshohen, si më poshtë vijon:

"Neni 1

Buxheti, për vitin 2021, është:

Të ardhurat	487 526	milionë lekë;
Shpenzimet	596 221	milionë lekë;
Deficiti	108 695	milionë lekë.

Ai përbëhet nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale, sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i ish-pronarëve.

Neni 2

Buxheti i shtetit, për vitin 2021, është

Të ardhurat	361 545	milionë lekë;
Shpenzimet	470 240	milionë lekë;
Deficiti	108 695	milionë lekë.

Neni 9

Të ardhurat e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Grantet	20 353	milionë lekë;
Të ardhurat tatimore	319 592	milionë lekë;
Të ardhurat jotatimore	21 600	milionë lekë.”.

Neni 2

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

1. Në nënndarjen “ – Shpenzime të buxhetit qendror ...” shifra “... 458 320 milionë lekë” zëvendësohet me “... 460 740 milionë lekë”.
2. Në nënndarjen “ – Fondi rezervë i buxhetit ...” shifra “... 2 000 milionë lekë” zëvendësohet me “... 3 000 milionë lekë”.
3. Tabelat 1 dhe 4, që përmenden në këtë nen, zëvendësohen me tabelat 1 dhe 4, që i bashkëlidhen këtij akti normativ.

Neni 3

Neni 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 14

Fondi rezervë prej 5 000 milionë lekësh përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për:

- raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme, në masën 3 000 milionë lekë, nga i cili 462 milionë lekë për pagesën e naftëtarëve;
- përballimin e kostos së zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2021, në masën 1 000 milionë lekë;
- hartimin e studimeve të projekteve të investimeve publike strategjike, në masën 1 000 milionë lekë.

Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4 500 milionë lekësh përdoret nga ministri përgjegjës për financat për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në shpenzimet për interesa.

Shumat e shpërndara nga fondi rezervë dhe kontingjenca për risqet e borxhit shtojnë kufijtë e miratuar në tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 11, të këtij ligji.”.

Neni 4

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet ne “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

**MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË**

ANILA DENAJ

A large, stylized handwritten signature in black ink, appearing to be 'Anila Denaj', written over the printed name.

NR.PROT. 7211
DATË 8.2.2021

KUVENDIT
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE
EKONOMISË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

